



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 30.04.2025  
Numër Protokoli: 2910/2025

A.nr. 690/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari- anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 690/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi R.A, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon** procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 690/2025, e datës 22.04.2025, e parashtruar nga ankuesi R.A.

## A r s y e t i m

Ankuesi R.A (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 22.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr. 690/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00014971, për “Grupin i Shkencave Shoqëror”, për pozitën ”Zyrat për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim”, të zhvilluar nga Komuna e Gjilanit.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit R.A, është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi R.A, ankesën me numër protokoli 2609/2025 të datës 22.04.2025, e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa kërkesën për tërheqje e ankesës e ka parashtruar me datën 25.04.2025 me numër protokoli 2739/2025, në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Prandaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se procedimi administrativ i iniciuar më ankesë është bërë i pamundur.

Ndërlidhur me tërheqjeje e ankesës nga ankuesi. Kolegji i Këshillit, pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankuesit konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *”Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj bazuar në këtë veprim administrativ të ankuesit, konstatohet se është përmbushur kushti ligjor për të vendosur për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër protokolli 2609/2025 e parashtruar nga ankuesi R.A.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendimin hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

### **Lënda me numër A.nr. 690/2025**

**Rushit Kajtazi**

**Eshref Shabani**

---

Procesmbajtjes

---

Kryetar Kolegji

#### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, R.A;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së